

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Permbajtja

1. Rezultate Financiare
2. Administrimi i Rrezikut
3. Administrimi i Rrezikut te Kredise
4. Administrimi i Rrezikut te Likuiditetit
5. Administrimi i Rrezikut te Valutes
6. Administrimi i Rrezikut te Normes se Interesit
7. Administrimi i Rrezikut Operacional dhe Mashtrimit
8. Mjaftueshmeria e Kapitalit
9. Politikat kontabel

Qershor 2019

1. Rezultate Financiare

Gjate tremujorit te dyte te vitit 2019, aktivet e pergjithshme te Bankes tregojne nje renie prej 2.2 milionë eurosh ose rreth 0.8% krahasuar me fundin e Dhjetorit 2018, duke arritur ne vleren 261,4 milion euro. Kjo renie eshte e lidhur ngushte me zhvillimin e portofolit te kredise dhe financimet e klienteve, i cili arrin ne vleren rreth 192.5 milion euro ne muajin Qershor 2019, duke pesuar nje renie me rreth 0.9% ose 1.7 milion euro nga fundi i Dhjetorit 2018.

Te ardhurat nga interesi, kane mbajtur po te njejtat nivele edhe pergjate tremujorit te pare te 2019, ne linje me ecurine e portofolit te kredise dhe kredive te reja te dhena gjate kesaj periuode. Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve eshte ndikuar pozitivisht nga rritja e te ardhurave nga tarifat dhe komisionet per klientet si dhe rezultatet e larta tregtare, kryesisht nga kembimet valutore dhe transaksionet e thesarit.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve eshte ndikuar negativisht nga të ardhura më të ulëta nga interesi nga portofoli i kredisë, si pasoje e normave me te uleta te interesit, pavaresisht rritjes se volumit, shpenzime më të larta administrative, shpenzime me te larta te provigjoneve duke bere qe mbulimi te mbetet i kënaqshëm në nivelin 112.5%, në përputhje me cilësinë e portofolit të huave si dhe të ardhura më të ulëta të interesit nga investimet ne letra me vlere.

Banka eshte vazhdimisht e fokusuar ne permiresimin e cilesise se portofolit. Mbulimi i portofolit ne vonese me fondin e provigjoneve eshte ulur me rreth 9.8% ne muajin Qershor 2019 krahasuar me tremujorin e katert te vitit 2018, duke arritur ne nivelin rreth 112.5% (BOA). Nderkohe, cilesia e portofolit (PAR) ka arritur në 6.12% në fund të muajit Qershor 2019.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

2. Administrimi i Rrezikut

Keshilli Drejtues ka përgjegjësinë përfundimtare për të zhvilluar dhe implementuar strukturat dhe mekanizmat e duhura për të identifikuar, vlerësuar dhe zvogëluar ekspozimin e bankës ndaj rrezikut. Keshilli Drejtues ka ngritur Komitetet e Administrimit të Rrezikut (Komiteti i Administrimit të Rrezikut të Kredise, Komiteti ALCO, Komiteti i Administrimit të Rrezikut Operacional dhe Komiteti i Administrimit të Rrezikut) për të monitoruar gamën e plote të rreziqeve ndaj të cilave ekspozohet banka. Për më tepër, këto Komitete kanë autoritet vendimtarë në lidhje me rrezikun.

Në bankën ProCredit Shqiperi rreziku matet dhe raportohet sipas politikave të administrimit të rrezikut, të cilat janë aprovuar nga Keshilli Drejtues i bankës. Politikat janë në përputhje të plote me rregulloret ligjore në fuqi në Shqipëri dhe me kërkesat e vendosura nga Banka e Shqiperise. Politikat bazohen në parimet dhe standartet e Grupit mbi Administrimin dhe Kontrollin e Rrezikut, të cilat nga ana e tyre bazohen në dokumenta udhëzues të Autoritetit Mbiqyrtës Financiar Federal Gjerman. Banka ProCredit Shqiperi raporton rregullisht pozicionin e saj kundrejt riskut tek Njesite e Administrimit të Rrezikut të Grupit (GRMC).

Kultura e bankës ProCredit për transparencën e brendshme dhe të jashtme është vendimtare në përpjekjet tona për administrimin e rrezikut. Fale procedurave tona të perkufizuara qarte dhe inkurajimit tonë për një komunikim të hapur, punonjësit tanë të trajnuar me se miri janë në një pozicion të fortë për të dalluar rreziqet dhe për të marrë hapat e nevojshëm për zvogëlimin e tyre.

3. Administrimi i Rrezikut të Kredise

Kredidhenia për SME-te përben operacionin kryesor të bankës ProCredit sa i përket aktiveve të saj dhe rrjedhimisht edhe rrezikun klasik të kredise, që nënkupton, rreziku që huamarresit mund të mos jënë në gjendje të paguajnë, është rreziku kryesor me të cilin përballë banka. Rreziku i kredise përben pjesën më të madhe të rrezikut në kontekstin e llogaritjes së kapacitetit të përballimit të rrezikut.

Banka ProCredit Shqiperi ka adoptuar politika të rrezikut të kredise bazuar në Politiken e Administrimit të Rrezikut të Kredise të Grupit ProCredit dhe Politiken e Vlerësimit të Kolateralit të Grupit, të cilat së bashku pasqyrojnë eksperiencën e fituar në më shumë se dy dekada operacimesh të suksesshme kredidhenie në ekonomitë në tranzicion dhe zhvillim dhe janë në përputhje të plote me rregulloret në fuqi në Shqipëri. Për çdo klient të bankës, caktohet një limit ekspozimi kredie dhe përcaktohet autoriteti vendimtarë për kredinë; të gjitha vendimet për të dhënë një kredi, ose për të ndryshuar kushtet, merren nga një komitet kredie dhe të gjitha vlerësimet e rrezikut të kredise dokumentohen me kujdes.

Mbi të gjitha, banka perpiqet të ndërtojë dhe ruajë marrëdhënie afatgjata me klientët e saj, duke u kujdesur që të jete plotësisht në dijeni të situatës së tyre financiare dhe të mos i ngarkojë ata me më shumë borxhe se sa kanë mundësi të paguajnë.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Rreziku i kredise zvogelohet gjithashtu nga fakti qe portofoli yne eshte shume i larmishem. Bizneset te cileve ne u sherbejme operojne ne nje game te gjere sektoresh dhe ekspozimi i tyre ndaj luhatjeve te tregut global eshte i limituar. Per me teper, pjesa me e madhe e ekspozimeve tona te kredise jane relativisht te vogla.

Duke qene se pjesa me e madhe e kredive te bankes paguhen me keste mujore, deshtimi i huamarresit per te permbushur afatin e pageses trajtohet si nje shenje fillestare e nje problemi potencial mosshlyerje dhe merr nje reagim te menjehershem nga banka. Kur nje pagese e interesit ose principalit eshte ne vonese per me shume se 30 dite, kredia ne fjale kalon te portofoli ne rrezik (PAR>30), i cili sherben si tregues kryesor per cilesine e portofolit te kredise dhe per matjen e rrezikut klasik te kredise.

Ne tremujorin e pare te vitit 2019, portofoli i pergjithshem ne vonese i bankes PAR>30 ka pesuar nje renie nga 6.68% ne muajin Mars 2019 ne 6.12% ne muajin Qershor 2019. Nje nga menytrat se si banka ProCredit kaperceu sfidat e cilesise se portofolit te shkaktuar nga kriza financiare eshte ofrimi i ristrukturimit te kredise per ata kliente te cilet vleresohen se kane potencial per te rifituar qendrueshmeri. Ristrukturimi vjen pas nje analize te hollesishme te kapacitetit pagues te ndryshuar te cdo klienti.

Vendimi per te ristrukturuar nje ekspozim kredie merret gjithmone nga nje komitet kredie dhe ka per qellim rikuperimin e plote te kredise. Banka ProCredit Shqiperi ka nje perqasje konservatore kundrejt provigjonimit te kredive te humbura. Jane vene ne dispozicion disa fonde per kredi individuale te konsiderueshme qe konsiderohen te ekspozuara ndaj rrezikut bazuar ne rezultatet e nje vleresimi te prekjes se tyre nga ky rrezik, kurse provigjionet per kredite e pacenuara, qe nuk jane te konsiderueshme individualisht, keto fonde jane llogaritur sipas normes historike te mos shlyerjes (default). Per te gjitha kredite qe nuk jane ekspozuar ndaj ndonje rreziku, jane parashikuar fonde mbulimi te bazuara ne portofol.

Ne fund te muajit Qershor 2019 raporti i mbulimit (provigjionet e kredive te humbura nen Metodologjine e Bankes se Shqiperise si nje perqindje e kredive ne vonese PAR>30) ishte 112%.

Ne parim, banka ProCredit pranon te gjitha llojet e kolateralit. Kolaterali sherben si garaci qe banka, si kreditor, te mund te rikuperoje ekspozimin e kredise dhe si motivim per huamarresin qe te paguaje ekspozimin e kredise. Vleresimi i kolateralit behet sipas Politikes se Vleresimit te Kolateralit te Grupit, i cili pasqyron eksperiencen e fituar ne me shume se dy dekada operacionesh te suksesshme kredidhenie dhe qe eshte ne perputhje me Standardet Europiane per Vleresimin e Kolateralit.

4. Administrimi i Rrezikut te Likuiditetit

Rreziku i likuiditetit afatshkurter specifikon rrezikun qe banka nuk do te jete me ne gjendje te permbushë plotesisht ose pjeserisht detyrimet e saj aktuale dhe te ardhshme te pagesave.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Prandaj, banka duhet të ruajë gjithmone fonde të mjaftueshme likuiditeti për të përmbushur detyrimet e saj, madje edhe në periudha të vështira. Disa faktore që janë pjesë e natyrshme e modelit të biznesit të bankës kompensojnë rrezikun e likuiditetit. Në pari, portofoli i kredive të bankës me larmishmerinë dhe cilësinë e lartë nënkupton që ka shumë mundësi të këtu fluks të parase në hyrje. Në dyti, Banka mban vazhdimisht në fokus mbledhjen e depozitave nga grupet e targetuara të bizneseve SME si dhe nga kursimet e klienteve individë, me të cilët ka ndertuar një marrëdhënie të fortë e cila siguron besueshmëri dhe në periudha të vështira. Përdorimi i instrumentave financiarë është në nivele të ulëta dhe Banka limiton në maksimum varesinë e situatës së likuiditetit nga to. Të gjithë këta faktore kufizojnë përqendrimet e mundshme të rrezikut të likuiditetit dhe garantojnë një sistem të thjeshtë të menaxhimit të këtij rreziku.

Për të përcaktuar fuqinë e likuiditetit të bankës përballë një goditjeje të mundshme, banka kryen teste stresi të rregullta bazuar në skenare të përcaktuar si standard në nivel grupi nga Politika e Administrimit të Rrezikut të Likuiditetit të Grupit. Supozimet mbi të cilat bazohen testet e stresit ndryshohen dhe përshtaten vazhdimisht për të pasqyruar kushtet e tregut. Kurdoherë që është e nevojshme të kapërcehen mungesat e likuiditetit, banka ProCredit Shqipëri mund të financohet nga një linjë krediti e garantuar dhe pa kushte nga ProCredit Holding.

5. Administrimi i Rrezikut të Valutes

Rreziku i valutes së huaj specifikon rrezikun e ndikimeve negative në rezultatet financiare të bankës dhe mjaftueshmërinë e kapitalit të shkaktuar nga ndryshimet në kurset e këmbimit. Banka ProCredit Shqipëri ka një nivel të ulët ekspozimi ndaj rrezikut të valutes pasi ajo nuk hyn në pozicione të hapura valutore spekulative, dhe as nuk angazhohet në transaksione që rrjedhin prej tyre. Rreziku i valutes administrohet në përputhje me Politikën e Administrimit të Rrezikut të Valutes së Huaj dhe rregulloret e Bankës së Shqipërisë mbi administrimin e rrezikut të valutes së huaj. Banka monitoron vazhdimisht lëvizjet e kursit të këmbimit dhe tregjet e valutes së huaj dhe menaxhon pozicionet e saj valutore në baze ditore. Teste stresi kryen rregullisht për të vlerësuar ndikimin e lëvizjeve të kursit të këmbimit të pozicionet e hapura valutore (OCP) në çdo valute.

6. Administrimi i Rrezikut të Normes së Interesit

Rreziku i normes së interesit specifikon rrezikun që lëvizjet në normat e interesit të tregut do të ndikojnë negativisht vlerën ekonomike të bankës si dhe fitimet e saj nga interesi dhe në fund dhe vetë kapitalin. Rreziku i normes së interesit administrohet në përputhje me Politikën e Administrimit të Normes së Interesit dhe udhëzuesin e Bankës së Shqipërisë mbi administrimin e rrezikut të normes së interesit në librin bankar. Ekspozimi ndaj rrezikut të normes së interesit matet nëpërmjet një analize të hendekut të maturimit. Testet e stresit kryen për të matur dhe analizuar ndikimin e ndryshimeve të normave të interesit në vlerën ekonomike të Bankës si dhe në të ardhurat nga interesat. Banka përpiqet të sigurojë sa më shumë përputhshmëri në strukturën e ricimit të aktiv-pasiv të saj sipas monedhave të ndryshme.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Gjithashtu, Banka perpiqet te perputhe sa me shume bazat e interesit (referencat) te perdorura per percaktimin e cmimeve te produkteve te saj, ne menyre qe te mos ndikohet nga ndryshimet ne normat baze reference te tregut te jashtem.

7. Administrimi i Rrezikut Operacional dhe Mashtrimit

Rreziku operacional perkufizohet si rreziku i humbjes qe vjen si rezultat i proceseve te brendshme te papershtatshme ose te pakryera, nga njerezit dhe sistemet, apo edhe nga ngjarje te jashtme. Ky perkufizim perfshin si rrezikun ligjor, ashtu edhe ate qe lidhet me reputacionin e bankes. Politika e rrezikut operacional e bankes ProCredit Shqiperi eshte ne perputhje te plote me rregulloret e Bankes se Shqiperise per administrimin e rrezikut operacional, me Politiken e Rrezikut Operacional te Grupit, si dhe me Politiken e Grupit per Parandalimin e Mashtrimit. Per te minimizuar rrezikun operacional dhe rrezikun e mashtrimit, te gjitha proceset dokumentohen me saktesi dhe u nenshtrohen mekanizmave efikase te kontrollit. Perskrimet e punes jane te plota, detyrat jane te ndara ne menyre strikte dhe eshte shmangur varesia nga individe kyç. Gjate rekrutimit, banka i kushton vemendje te veçante integritetit personal, nje cilesi qe perforcohet permes zbatimit strikt te kodit te sjelljes se bankes dhe permes programeve gjithepershiresë te trajnimit te hartuara per te promovuar nje kulture transparence dhe ndergjegjesimi per rrezikun.

Çeshtjet e rrezikut operacional rishikohen nga Komiteti i Rrezikut Operacional, i cili drejtohet nga nje anetar i Drejtorise Ekzekutive. Ai ka per qellim te percaktojë politika per rreziqet qe lidhen me njerezit, rreziqet qe lidhen me proceset, rreziqet qe lidhen me teknologjine e informacionit dhe sistemet, rreziqet e jashtme dhe aspekte te tjera te rrezikut operacional, si dhe te monitorojë respektimin e ketyre politikave. Ai, gjithashtu, diskuton edhe hedhjen e te dhenave te rendesishme ne Bazen e te Dhenave te bankes per Ngjarjet e Rrezikut.

Baza e te dhenave te te gjithë grupit per Ngjarjet e Rrezikut (RED) siguron qe rreziqet operacionale dhe ato te mashtrimit te adresohen sistematikisht dhe me transparence dhe qe te gjitha hapat korigjuese apo parandaluese te dokumentohen qarte dhe te jene te aksesueshme per kontrollin nga niveli menaxhues, si ne nivel banke, ashtu edhe ne nivel grupi. Punonjesve u kerkohet qe te raportojne te gjitha ngjarjet qe perfaqesojne nje humbje faktike apo te mundshme prej me shume se 100 Eurosh, duke perdorur nderfaqen e RED. Ngjarje te raportuara qe permbajne rreziqet me te shtrira, dhe qe konsiderohen si ngjarjet me me shume gjasa per t'u perseritur, i nenshtrohen nje analize te thelle nga Komiteti i Rrezikut Operacional, i cili me vone propozon masat e pershtatshme parandaluese.

Nje aspekt kyç i administrimit te rrezikut eshte kultura e rrezikut te institucionit, e cila u perçohet te gjithë punonjesve permes trajnimeve sistematike. Si pjese e trajnimit te tyre fillestar, te gjithë anetareve te rinj te stafit u mesohet se si ta dallojne dhe ta shmangin rrezikun operacional dhe ate te mashtrimit dhe si te ruajne sigurine e informacionit.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

8. Mjaftueshmeria e Kapitalit

Mjaftueshmeria e kapitalit te bankes llogaritet çdo muaj dhe i raportohet si Drejtorise Ekzekutive, ashtu edhe Bankes se Shqiperise dhe Komitetit te Administrimit te Rrezikut te Grupit, se bashku me parashikimet aktuale per te siguruar perputhshmerine ne te ardhmen me kerkesat per mjaftueshmerine e kapitalit.

Edhe ne kete aspekt, mbeshtetja e forte e aksionereve tane i ka dhene mundesi bankes qe te ruaje nje nivel komod kapitali. Me 30 Qershor 2019, raporti i mjaftueshmerise se kapitalit (kapitali i nivelit 1 dhe nivelit 2/asetet e ponderuara me rrezik) ishte ne nivelin e 13.31% (Metodologjia e Bankes se Shqiperise), me lart ne krahasim me standardin minimal te te gjithë grupit, qe eshte 12% dhe qe eshte ne te njejten kohe edhe minimumi i kerkuar ne vend.

Objektivat e bankes ne administrimin e kapitalit, qe eshte nje koncept me i gjere sesa 'equity' sa i perket bilancit, jane:

- te veproje ne perputhje me kerkesat per kapital te vendosura nga Banka e Shqiperise;
- te mbroje mundesine e bankes per te vazhduar si nje pune ne proces, ne menyre qe ajo te mund te vazhdoje t'u ofroje fitime aksionereve dhe perfitime aktoreve te tjere te interesuar; dhe
- te ruaje nje baze te forte kapitali per te mbeshtetur zhvillimin e biznesit te saj.

Mjaftueshmeria e kapitalit dhe perdorimi i kapitalit rregullator monitorohen çdo dite nga niveli menaxhues i Bankes, duke perdorur teknika te bazuara ne udhezimet e hartuara nga Komiteti i Bazelit dhe Direktivat e Komunitetit European, siç jane vene ne zbatim nga Banka e Shqiperise, per qellime mbikeqyrese. Informacioni i kerkuar depozitohet ne Banken e Shqiperise çdo tre muaj.

Banka e ka zbatuar Metodologjine sipas Rregullores se Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise per Mjaftueshmerine e Kapitalit, miratuar me Vendimin Nr.48, date 31.07.2013, ndryshuar me vendimin nr.43, datë 30.07.2014, ndryshuar me vendim nr. 70, datë 18.12.2014 dhe ndryshuar me vendim nr. 49, datë 01.07.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Banka llogarit mjaftueshmërinë e kapitalit si raport ndërmjet shumës së kapitalit rregullator me shumën e ekspozimeve të ponderuara me rrezikun, e shprehur në përqindje, në baza individuale dhe të konsoliduara. Banka sigurojn që raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit, i llogaritur si me siper, të jetë jo më i vogël se 12%.

Banka llogarit ekspozimet e ponderuara me rrezikun, si shumë e elementëve të mëposhtëm:

- a) zërave të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme, të ponderuara me rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpatisë, të llogaritura sipas Metodës Standarde, të përcaktuar respektivisht në kreun III dhe në kreun VI të rregullores se Keshillit Mbikeqyres te Bankes se Shqiperise per Mjaftueshmerine e Kapitalit;

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

- b) kërkesës për kapital për rrezikun e tregut, të llogaritur sipas kërkesave të përcaktuara në kreun VII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5;
- c) kërkesës për kapital për rrezikun operacional, të llogaritur sipas Metodës së Treguesit të Thjeshtë ose sipas Metodës Standarde, të përcaktuara në kreun VIII të kësaj rregulloreje, të shumëzuara me 12.5.

Banka llogarit kapitalin rregullator sipas udhëzimit të Bankës së Shqipërisë "Për kapitalin rregullator të bankës", miratuar me vendimin nr. 69 datë 18.12.2014, ndryshuar me vendimin nr. 19, datë 04.03.2015 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.

Kapitali rregullator është kapitali i bankës, i llogaritur sipas kërkesave të kësaj rregulloreje, për mbulimin e rrezikut të kredisë, të rreziqeve të tregut dhe të rrezikut operacional. Kapitali rregullator i bankës, në varësi të karakteristikave të tij dhe kushteve të përcaktuara në këtë rregullore, ndahet në dy kategori:

- a) kapitali i nivelit të parë;
- b) kapitali i nivelit të dytë.

Banka llogarit kapitalin rregullator të saj si shumë të kapitalit të nivelit të parë dhe kapitalit të nivelit të dytë, duke marrë në konsideratë, edhe zbritjet sipas kërkesave të kësaj rregulloreje dhe/ose të akteve të tjera rregullative.

Bazuar ne kerkesat e Bankes se Shqiperise, Banka ProCredit: (a) mban nivelin minimal te kapitalit rregullator prej 1 miliard leke (b) ruan nje raport total rregullator me asete te ponderuara me rrezik ('raporti i Bazelit') ne nivelin e pranuar nderkombetarisht prej 12% ose me lart, dhe vepron ne perputhje me keto kerkesa.

Gjithashtu, Banka kryen vleresimin e brendshem te mjaftueshmerise se kapitalit ne baze vjetore, bazuar politikat e brendshme te Grupit dhe ne kerkesat e Udhezuesit te Bankes se Shqiperise "Mbi procesin e vleresimit te brendshem te mjaftueshmërisë së kapitalit".

Banka percakton aftesine e saj per te mbartur risk, bazuar ne elemente te caktuar te kapitalit dhe ne linje me kete percakton disa limite te brendshem, deri ne cilin nivel te kesaj vlere duhet te shkoje totali I kapitaleve ekonomike te nevojshem, per te mbuluar kategorite e ndryshme te risqeve materiale.

9. Politikat kontabel

Banka pergatit pasqyrat financiare ne perputhje me "Metodologjine e Raportimit Financiar", aprovuar nga Keshilli Mbikeqyres i Bankes se Shqiperise ne date 24 Dhjetor 2008, bazuar edhe ne nenin 47 te ligjit Nr.9662, date 18 Dhjetor 2006 "Per Bankat ne Republiken e Shqiperise". Kjo metodologjia eshte aprovuar per ceshtje raportimi dhe politikat kontabel lidhur me kete metodologji jane pjese e raportit vjetor te publikuar te Bankes.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Gjithashtu Banka përgatit pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK). Bazat e politikave kontabel janë si vijojne:

a) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, duke bërë përjashtim vetëm për mjetet financiare të letrave me vlere të vendosjes, të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

b) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale e Bankës. Me përjashtim të rasteve kur shprehet në mënyrë të veçantë, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të mjtën më të afërt.

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e ndryshimeve në kapital konvertohen me kursin e këmbimit zyrtar të Bankës së Shqipërisë në datën e raportimit. Pasqyra e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyra e fluksit të parasë janë konvertuar me kursin e këmbimit mesatar për periudhën.

c) Përmbledhje e vleresimeve dhe gjykimeve kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të bëjë gjykimet, vleresimet dhe supozimet të cilat prekin zbatimin e politikave kontabël dhe vlerat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vleresime. Vleresimet dhe supozimet në fjalë rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vleresimeve kontabël njihen në periudhën gjatë të cilës rishikohen vleresimet si dhe në periudha të tjera në të ardhmen.

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e pasqyrave financiare si dhe janë aplikuar vazhdimisht nga Banka.

d) Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet e interesit njihen në pasqyrën e të ardhurave me anë të metodës së normës efektive të interesit. Norma efektive e interesit është norma e cila bën aktualizimin e flukseve të pagesave dhe arkëtimeve të pritshme në të ardhmen gjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitetit ose detyrimit financiar (ose sipas rastit mund të jetë një periudhë më e shkurtër) deri në shumën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Për përcaktimin e normës efektive të interesit, Banka vlerëson fluksin e parasë në të ardhmen, duke marrë në konsideratë kushtet kontraktore të instrumentit financiar, por jo humbjet e kredisë në të ardhmen.

Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të arkëtuara, shpenzimet për transaksionet, dhe zbritjet ose primet që janë pjesë e normës efektive të interesit. Shpenzimet e transaksionit janë shpenzime shtesë që i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes, emetimit ose shitjes së një aktivi ose detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat paraqiten në pasqyrën e fitim humbjeve dhe të ardhurave të tjera përmbledhëse përfshijnë:

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

- interesat për aktivet financiare dhe detyrimet financiare të cilat maten me koston e amortizuar llogariten në bazë të normës efektive të interesit; dhe
- interesat për investime në letra me vlerë të vendosjes llogariten në bazë të normës efektive të interesit.

e) Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit. Të ardhurat e tjera nga komisionet, përfshirë komisionet e shërbimit të llogarisë, komisionet për shitje dhe vendosje depozite njihen në momentin e kryerjes së shërbimeve. Shpenzime të tjera për komisionet lidhen kryesisht me komisionet për transaksione dhe shërbime, të cilat kalojnë në shpenzime në momentin e marrjes së shërbimit të ofruar.

f) Qiraja operative

Shpenzimet për qiranë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare përgjatë kohëzgjatjes së qirasë. Incentivat e qirasë njihen si pjesë integrale të totalit të shpenzimeve për qiratë gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

g) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve valutore janë kthyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit janë këmbyer në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e këmbimit. Fitimi ose humbja nga këmbimet valutore të zërave monetar është diferenca midis koston të amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston të amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të ditës në fund të periudhës.

Zërat jo-monetar të cilat maten me koston historike në monedhë të huaj konvertohen me kursin historik të këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat e konvertimit të cilat rezultojnë nga rikonvertimet njihen përgjithësisht në pasqyrën e të ardhurave.

h) Tatimi mbi fitimin

Shpenzimet për tatimet përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera përmbledhëse.

(i) Tatimi afatshkurtër

Tatimi afatshkurtër është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, duke përdorur normat e taksave në fuqi ose të cilat hyjnë në fuqi në datën e raportimit, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet në lidhje me vitet e mëparshme.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përlllogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës së mbartur të të drejtave dhe detyrimeve për qëllime raportimi dhe vlerës së përdorur për qëllime tatimi. Tatimi i shtyrë nuk

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

përlogaritjet mbi diferencat e përkohshme të njohjes fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion i cili nuk është një kombinim biznesi dhe nuk ka ndikim as mbi kontabilizimin si dhe as në të ardhurat e tatueshme apo shpenzimet.

E drejta tatimore e shtyrë njihet për humbjet e papërdorura tatimore, kreditimet tatimore dhe diferencat tatimore të zbritshme deri në atë nivel ku është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të materializohet. Të drejtat tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen deri në atë nivel që nuk ka më mundësi që të realizohet fitimi nga tatimet.

Tatimi i shtyrë matet me normat e tatimeve të cilat janë parashikuar të zbatohen mbi diferencat e përkohshme në momentin e kthimit të tyre, duke përdorur normat e tatimeve në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

Të drejtat dhe detyrimet e shtyra tatimore kompensohen me njëra-tjetrën, nëse një e drejtë e detyrueshme ligjore ekziston për të kompensuar një të drejtë tatimore afatshkurtër kundrejt një detyrimi tatimor afatshkurtër dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtët subjekte të tatueshëm dhe autoritet tatimor, ose me subjekte të ndryshme tatimore, por ata kanë si qëllim të likuidojnë detyrimet dhe të drejtat tatimore afatshkurtra neto ose të drejtat dhe detyrimet e tyre tatimore do të realizohen njëkohësisht.

(iii) Ekspozimi tatimor

Për përcaktimin e vlerës së tatimit afatshkurtër dhe të shtyrë, Banka merr në konsideratë ndikimin e pozicioneve të pasigurta tatimore dhe nëse duhet të paguhet tatime shtesë dhe interesa. Ky vlerësim mbështetet në vlerësimet dhe supozimet dhe mund të përfshijnë një sërë gjykimesh për ngjarje në të ardhmen. Të dhëna të reja mund të bëhen të disponueshme, si rezultat i të cilave Banka të ndryshojë gjykimin e saj në lidhje me mjaftueshmërinë e detyrimeve tatimore ekzistuese; këto ndryshime të detyrimeve tatimore do të prekin dhe shpenzimin për tatimet për periudhën gjatë të cilës bëhet përcaktimi.

i) Aktive financiare dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Banka fillimisht njeh huat dhe paradhëniet, depozitat dhe huamarrjet në datën kur ato janë krijuar. Të gjitha instrumentet e tjera financiare (duke përfshirë blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare) njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit.

Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus, për një instrument që nuk matet me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave, kostot e transaksionit të cilat i atribuohen direkt blerjes ose emetimit të tij

(ii) Klasifikimi

Aktivet financiare

Banka klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Letra me vlere te vendosjes

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Drejtimi i Bankës përcakton klasifikimin e investimeve të saj me njohjen fillestare. Banka nuk ka klasifikuar ndonjë aktiv financiar me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave të shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit.

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, ndryshe nga garancitë financiare dhe angazhimet e huas, si të matura me koston e amortizimit.

(iii) Mos-njohja

Aktivitet financiare

Banka nuk e njeh më një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale për flukset e parave nga aktivi janë shuar, ose nëse transferohen të drejtat për të marrë përfitimin kontraktual nga aktivi financiar në një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin financiar ose në të cilin Banka nuk transferon dhe nuk mban në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe shpërblimet e pronësisë si dhe nuk gëzon kontrollin ndaj aktivitetit financiar.

Për mos njohjen e një aktivi financiar, diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit (ose vlera e mbartur që i është caktuar pjesës së aktivitetit që nuk njihet) dhe shumës së (i) pagesës së arkëtuar (duke përfshirë aktivin e ri që është marrë duke i zbritur detyrimet e reja të supozuara) dhe (ii) çdo fitim ose humbje kumulative që është njohur në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse, njihet në pasqyrën e të ardhurave. Çdo interes në aktivitetet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare

Banka nuk njeh një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë shfuqizuar, anuluar ose kur u skadon afati.

(iv) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur dhe vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e shumave dhe vlerave, dhe ka si qëllim likuidimin mbi bazën neto ose likuidimin e aktivitetit dhe shlyerjen e detyrimit njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit – Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizuar e aktivitetit ose detyrimit financiar përbën shumën me të cilën aktivi dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare, minus kthimin e principalit, plus ose minus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për të gjitha ndryshimet midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës së maturuar, duke zbritur ndonjë humbje nga zhvlerësimi.

(vi) Matja me vlerën e drejtë

'Vlera e drejtë' është çmimi i cili do të përcaktohet për të shitur një aktiv ose do të paguhet për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt midis pjesëmarrësve në treg në datën e matjes në principal, ose në mungesë të tij, tregu më i favorshëm në të cilin Banka ka akses në atë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës së tij.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Nëse është e mundur, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimin e kuotuar në një treg aktiv për instrumentin. Një treg konsiderohet si treg aktiv nëse transaksionet për aktivet dhe detyrimet ndodhin me një frekuencë dhe në volume të mjaftueshme për të paraqitur informacion dhe të dhëna për çmimin në mënyrë të vazhdueshme. Në rast se në një treg aktiv nuk ka një çmim të kuotuar, atëherë Banka përdor teknikat e vlerësimit të cilat maksimizojnë përdorimin e informacioneve dhe të dhënave të evidentueshme dhe vëzhgueshme si dhe minimizojnë përdorimin e informacioneve dhe të dhënave jo të evidentueshme dhe të pavëzhgueshme. Teknika e vlerësimit të zgjedhur përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit në treg duhet të marrin në konsideratë për përcaktimin e çmimit të një transaksioni.

Evidenca më e mirë për vlerën e drejtë e një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit – p.sh. vlera e drejtë e pagesës së kryer ose të arkëtuar. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose detyrim të njëjtë dhe as në bazë të një teknike vlerësimi e cila përdor vetëm të dhëna nga tregje të evidentueshme dhe vëzhgueshme, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, e cila rregullohet për pranuar ndryshimin midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimit të transaksionit. Për rrjedhojë, diferenca njihet në pasqyrën e të ardhurave siç duhet përgjatë jetëgjatësisë së instrumentit por jo më vonë se koha kur vlerësimi mbështetet plotësisht nga të dhëna të evidentueshme dhe vëzhgueshme në treg ose koha e mbylljes së transaksionit.

Nëse një aktiv ose detyrim i cili matet me vlerën e drejtë, ka një çmim ofertë dhe një çmim kërkesë, atëherë Banka mat pozicionet e aktiveve dhe pozicionet afat gjata me çmimin e ofertës dhe detyrimet dhe pozicione afat shkurtra me çmimin e kërkesës.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më e vogël se shuma që paguhet në bazë të kërkesës, e zbritur nga data e parë në të cilën mund të kërkohej pagesa e shumës. Banka i njeh transfertat midis niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës së raportimit gjatë të cilës ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Zhvlerësimi i huave dhe paradhënive

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare janë të zhvlerësuar. Nëse ekzistojnë fakte objektive që vërtetojnë se ka ndodhur zhvlerësimi i një ekspozimi kredie ose i një portofoli të ekspozimeve të kredisë i cili ka një impakt në flukset e ardhshme të parasë të aktivitetit financiar (aktiveve), humbjet e përkatëse njihen menjëherë. Në varësi të madhësisë së ekspozimit të kredisë, këto humbje llogariten për çdo ekspozim kredie më vete ose vlerësohen së bashku kolektivisht për një portofol të ekspozimeve të kredisë. Vlerësimi kolektiv është vendosur për banka me hua homogjene të cilat nuk konsiderohen individualisht të rëndësishme; dhe bankat e aktiveve të cilat janë individualisht të rëndësishme por që nuk rezultuan të zhvlerësuar individualisht. Vlera e mbartur e kredisë zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të llogarisë së provigjioneve dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave. Banka nuk i njeh humbjet nga ngjarje të pritshme në të ardhmen

Hua dhe paradhënie të vlerësuar individualisht

Banka vlerëson në fillim nëse ekzistojnë faktet objektive të zhvlerësimit veçmas në mënyrë individuale për aktivet financiare të janë të rëndësishme më vete, dhe veçmas ose në mënyrë

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

kolektive për aktivet financiare të cilat nuk janë të rëndësishme më vete. Ekspozimet e kredisë vlerësohen individualisht të rëndësishme nëse kanë një madhësi të caktuar. Të gjitha ekspozimet e kredisë mbi EURO / USD 30,000 vlerësohen individualisht për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë shenjë zhvlerësimi e cila mund të sjellë një humbje nga zhvlerësimi p.sh. çdo fakto që mund të influencojë aftësinë e klientit për të përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj Bankës. Kriteret që Banka përdor për të përcaktuar se ekzistojnë fakte objektive për një humbje nga zhvlerësimi përfshijnë si më poshtë vijon:

- moskryerja e pagesave të principalit dhe interesave sipas kontratës, në mënyrë të veçantë ato me mbi 30 ditë vonesë;
- shkelja e kushteve dhe afateve të kredisë;
- fillimi i procedurave të falimentimit ose riorganizimit financiar;
- fillimi i procedurave gjyqësore nga Banka;
- të gjithë ose një pjesë e ekspozimit jashtë bilancit të një klienti tregon shenja zhvlerësimi;
- çdo informacion specifik për aktivitetin e biznesit të klientit që parashikohet të ketë një ndikim negativ në fluksin e ardhshëm të parasë; dhe
- ndryshimet në mjedisin e tregut të klientit që parashikohen të ketë një ndikim negativ në fluksin e ardhshëm të parasë.

Gjatë përcaktimit të fondit rezervë për zhvlerësim, duhet të merret në konsideratë ekspozimi agregat ndaj klientit dhe shumat e pritshme nga kolaterali i vendosur si garanci.

Në rast se ekzistojnë fakte objektive që ka ndodhur një humbje nga zhvlerësimi, vlera e humbjes matet si diferenca midis vlerës së mbartur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të skontuar me normën fillestare efektive të interesit të aktivitetit financiar (zhvlerësim specifik). Nëse ekspozimi i kredisë ka një normë të ndryshueshme interesi, norma e zbritjes për matjen e humbjes nga zhvlerësimi është norma efektive e interesit aktual. Llogaritja e vlerës aktuale të fluksit të ardhshëm të parasë të një aktiviteti financiar i cili është vendosur si garanci pasqyron fluksin e parasë që mund të rezultojë nga mbyllja minus kostot sigurimin dhe shitjen e kolateralit.

Hua dhe paradhënie të vlerësuara kolektivisht

Për qëllime të vlerësimit të zhvlerësimit kolektiv, aktivet financiare grupohen në bazë të karakteristikave të ngjashme të riskut të kredisë p.sh. sipas numrit të ditëve të vonesave. Vonesa prej më shumë se 30 ditë konsiderohet një tregues zhvlerësimi.

Vlerësimi kolektiv i zhvlerësimit për ekspozimet e kredisë individualisht jo të rëndësishme (fondi rezervë për huatë të zhvlerësuara individualisht të parëndësishme) dhe për ekspozimet e kredisë të pazhvlerësuara (fondi rezervë për huatë të zhvlerësuara kolektivisht) bazohet në analizën sasiore të normave të vonesës për portfolet e kredisë me karakteristika të ngjashme risku (analiza e migrimit). Pas analizës sasiore të këtyre të dhënave statistikore, drejtimi i ProCredit Holding përcakton normat e duhura të cilat duhet të përdoren si bazë për fondet e zhvlerësimit sipas portofolit. Këto norma janë subjekt i ri-testimit të përvitshëm.

Flukset e ardhshme të parasë në një grup të aktiveve financiare të cilat vlerësohen në mënyrë kolektive për zhvlerësim përllogariten në bazë të flukseve të parasë kontraktore të aktiveve në grup dhe eksperiencës së humbjes historike për aktive me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë më ato të grupit.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Eksperienca e humbjes historike rregullohet në bazë të të dhënave aktuale të evidentueshme dhe të vëzhgueshme për të pasqyruar efektet e kushteve aktuale që nuk cenuan periudhën në të cilën bazohet eksperienca e humbjes historike dhe për të hequr efektet e kushteve në periudhën historike që nuk ekzistojnë aktualisht. Metodologjia dhe supozimet që përdoren për vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë rishikohen rregullisht nga Banka për të zvogëluar çdo diferencë midis vlerësimit dhe përlogaritjeve të humbjes dhe eksperiencës së humbjes aktuale.

Rikthimi i zhvlerësimit

Nëse, në një periudhë të mëvonshme, shumat e humbjes së zhvlerësuar zvogëlohet ose dhe zvogëlimi lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit humbja nga zhvlerësimi që është njohur më parë, kthehet duke rregulluar llogarinë e provizionit. Shuma e kthimit njihet në pasqyrën e të ardhurave.

Fshirja e huave dhe paradhënieve

Nëse një hua nuk mund të arkëtohet, ajo fshihet kundrejt provizionit përkatës për zhvlerësimin e huas. Këto hua fshihen pas përfundimit të të gjitha procedurave të nevojshme dhe përcaktimit të shumës së humbjes. Rikuperimet e mëvonshme të shumave që janë fshirë më parë njihen në pasqyrën e të ardhurave si pjesë e provizionit për humbjet nga zhvlerësimi të huave dhe paradhënieve.

Ekspozimet e kredive të ristrukturuara

Ekspozimet e kredive të ristrukturuara që janë në vonesë ose të zhvlerësuar dhe të cilat konsiderohen individualisht të rëndësishme vlerësohen individualisht (shih më sipër). Kreditë e ristrukturuara të cilat janë individualisht jo të rëndësishme vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim.

Aktivitet e marra në këmbim për huat (pronat e marra në zotërim)

Pronat e marra në zotërim përbëjnë aktivitet jo-financiare të marra në zotërim të cilat janë përfituar nëpërmjet ekzekutimit të garancive të kredive me probleme dhe paradhënieve të klientëve të cilët nuk gjenerojnë të ardhura qiraje dhe nuk përdoren nga Banka dhe janë planifikuar për shitje brenda një kohë të shkurtër të arsyeshme, pa ristrukturime të rëndësishme. Aktivitet e marra në zotërim përfshihen tek mjetet e tjera dhe maten me koston dhe vlerën më të ulët neto të realizueshme dhe vlera njihet në pasqyrën e të ardhurave së bashku me të gjitha të ardhurat dhe humbjet nga shitja e tyre.

Zhvlerësimi i letrave me vlerë të vendosjes

Në çdo datë raportimi, Banka vlerëson nëse ekzistojnë fakte objektive që një aktiv financiar ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohet. Në rastin kur investimet e kapitalit klasifikohen në kategorinë e letrave me vlerë vendosjes, rënia e ndjeshme dhe madhe në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën koston e saj mere në konsideratë për të përcaktuar nëse aktivitet janë zhvlerësuar. Nëse këto fakte objektive ekzistojnë për aktivitet financiare të letrave me vlerë të vendosjes, humbja kumulative, e cila vlerësohet dhe matet si diferenca midis koston së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve financiare të cilat janë njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, hiqet nga zëri i të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Humbjet nga zhvlerësimi që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për instrumentet e kapitalit nuk kthehen përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Nëse në një periudhë të mëvonshme, vlera e drejtë

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

e instrumentit të borxhit që klasifikohet në kategoritë e letrës me vlerë të vendosjes rritet, dhe rritja lidhet objektivisht me një ngjarje që ndodh pas datës së zhvlerësimit, humbja është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, humbja nga zhvlerësimi kthehet përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

j) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe të ngjashme përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me bankat, gjendjet e pakufizuara me bankat qendrore dhe depozitat afatshkurtra shume likuide me maturitet më pak se tre muaj ose më pak se data e blerjes, të cilat janë subjekt i ndryshimeve jo të rëndësishme të vlerës së tyre të drejtë dhe përdoren nga Banka për përmbushjen e angazhimeve të saj afatshkurtra. Mjete monetare dhe të ngjashme mbahen në bilanc me koston e amortizuar.

Huate dhe paradhëniet

Huate dhe paradhëniet për bankat dhe klientët janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme të cilat nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Huat dhe paradhëniet për bankat dhe klientët klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme. Huat dhe paradhëniet maten në fillim me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizimit plus koston e tjera të transaksioneve direkte, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Kur Banka ble një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për rishitjen e aktivit (ose një aktivi tjetër të ngjashëm) me një çmim të caktuar fiks në datë të caktuar (marrëveshjet e riblerjes së anasjelltë), marrëveshja kontabilizohet si një hua ose paradhënie, dhe aktivi në fjalë nuk njihet në pasqyrat financiare të bankës.

k) Aktive financiare letra me vlerë të vendosjes

Investimet në letra me vlerë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e letrave me vlerë jo të tregtueshme, koston e tjera të transaksioneve direkte.

Investimet në letrat me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk përbëjnë një kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të vendosjes përfshijnë letrat me vlerë të kapitalit dhe letra me vlerë të borxhit. Letrat me vlerë të borxhit të pakuotuar, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha letrat me vlerë të vendosjes maten me vlerën e drejtë pas njohjes fillestare.

Te ardhurat nga interesi njihen në pasqyrën e të ardhurave nëpërmjet metodës së interesit efektiv. Të ardhurat nga dividendët njihen në pasqyrën e të ardhurave kur Banka gëzon të drejtën mbi dividendin. Fitimet ose humbjet nga këmbimet valutore të investimeve në letra me vlerë të vendosjes njihen në pasqyrën e të ardhurave. Humbjet nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë, përveç humbjeve nga zhvlerësimi njihen tek pasqyra e të ardhurave të tjera përmbledhëse dhe paraqitet në rezervën e vlerës së drejtë të kapitalit. Nëse investimi shitet, gjendja në kapital, më parë e njohur në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse, riklasifikohet në pasqyrën e të ardhurave.

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

l) Ndërtesat dhe pajisjet

Ndërtesat dhe pajisjet paraqiten me koston e tyre historike neto pasi iu është zbritur zhvlerësimi i akumuluar dhe ndonjë humbje nga zhvlerësimi. Kostot historike përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat mund t'i atribuohen në mënyrë të drejtpërdrejtë blerjes së mjetit.

Shpenzimet e mëtejshme janë përfshirë në vlerën e mbartur të aktivit, ose njihen si një aktiv më vete, sipas rastit, në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivit mund të maten në mënyrë të besueshme. Të gjitha riparimet e tjera dhe mirëmbajtja klasifikohen tek shpenzimet operative gjatë periudhës financiare gjatë cilës janë kryer këto shpenzime.

Vlera e mbartur e ndërtesave dhe pajisjeve rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Nëse ekzistojnë këto tregues dhe nëse vlera e mbartur tejkalon shumën e përlogaritur që mund të rikuperohet, aktive ose njësitë gjeneruese të mjeteve monetare fshihen nga shuma e tyre e rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme e ndërtesave dhe pajisjeve është shuma më e madhe e vlerës së drejtë duke i zbritur shpenzimet për shitjen e tyre dhe vlerën në përdorim. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Trojet dhe aktivet në ndërtim nuk zhvlerësohen. Zhvlerësimi i aktiveve realizohet duke përdorur metodën lineare sipas normave të përcaktuara për koston dhe shpenzimet për pronën dhe pajisjet gjatë kohëzgjatjes së përdorimit të tyre. Normat vjetore të zhvlerësimit përcaktohen në bazë të jetëgjatësisë së parashikuar të aktiveve të caktuara sipas tabelës që paraqitet më poshtë:

Përshkrimi

Kompjuter dhe pajisje elektronike
Automjete
Mobilje dhe pajisje
Ndërtesa

Jetëgjatësia

5 vjet
5 vjet
10 vjet
40 vjet

Përmirësimet e mjediseve me qira zhvlerësohen gjatë periudhës së kontratës së qirasë.

Vlerat e mbetura të aktiveve dhe jetëgjatësia e përdorimit rishikohen dhe rregullohen, sipas rastit, në datën e raportimit. Fitimet dhe shpenzimet për shitjet përcaktohen duke krahasuar të ardhurat me vlerën e mbartur. Këto përfshihen në zërin e të ardhurave të tjera ose në zërin e shpenzimeve të tjera operative (sipas rastit) të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

Investimet në prona mbahen nga Banka për të fituar të ardhura nga qiraja ose për vlerësimin e kapitalit, ose për të dyja qëllimet. Investimet në prona përfshijnë aktivet për përdorime në të ardhmen për qëllime investimi.

m) Aktive afat-gjata jomateriale

Aktive afat-gjata jomateriale njihen në rast se ekzistojnë mundësi të rrisin të mirat e ardhshme ekonomike të këtij mjeti specifik në Bankë dhe shpenzimet e aktivit mund të maten në mënyrë të besueshme. Aktive afat-gjata jomateriale maten dhe vlerësohen fillimisht me kosto. Vlera e mbartur e aktiveve afat-gjata jomateriale rishikohen për zhvlerësim nëse ngjarjet ose

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

ndryshimet e rrethanave evidentojnë se vlera e mbartur nuk mund të rikuperohet. Aktive afatgjata jomateriale përfshijnë programet kompjuterike të cilat amortizohen duke përdorur metodën lineare të amortizimit për të gjithë jetëgjatësinë e dobishme prej dhjetë vjet.

n) Depozitat dhe borxhet e varura

Depozitat dhe borxhet e varura përbëjnë burimet e financimit të Bankës.

Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivitetit (ose të një aktiviteti të ngjashëm) me çmim fikse në një datë të ardhshme (marrëveshje të shitjes dhe riblerjes) marrëveshja kontabilizohet si depozite, dhe aktiviteti në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës. Depozitat dhe borxhet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot direkte të transaksionit, dhe me pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

o) Provizionet

Një provizion mund të njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka disponon një detyrim ligjor ose konstruktiv që mund të vlerësohet me besueshmëri dhe që gjithashtu është e mundur që të kërkojë dalje të përfitimeve ekonomike për të mbyllur detyrimin. Provizionet përcaktohen duke përdorur si normë skontimi për flukset e pritshme të parasë në të ardhmen, një normë para taksës e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe specifikat e riskut për detyrimin. Konvertimi i zbritjes njihet si kosto dhe shpenzim financiar.

p) Përfitimet e punonjësve

Banka operon vetëm me pagimin e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat gjenerojnë përfitime pensioni për punonjësit. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin pragun minimal ligjor për pensionet në Shqipëri sipas një plani të përcaktuar të kontributeve për pension. Kontributet e Bankës në planin e pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave në momentin e pagesës.

q) Garancitë financiare dhe angazhimet e huase

Garancitë financiare janë kontrata që kërkojnë që Banka të realizojë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që ka ndodhur si rezultat i mungesës së pagesës sipas termave kontraktuale për një instrument borxhi nga një debitor i caktuar. Angazhimet e huase janë angazhime të qëndrueshme për të ofruar kredi sipas termave dhe kushteve të përcaktuara paraprakisht. Këto angazhime financiare regjistrohen në pasqyrën e pozicionit financiar nëse dhe në momentin kur janë të pagueshme.

r) Kapitali aksioner

(i) Kostot për emetimin e aksioneve

Kostot dhe shpenzimet shtesë që i atribuohen në mënyrë direkte emetimit të aksioneve të reja paraqiten në kapital si një zbritje nga të ardhurat pa tatimin, neto.

(ii) Primi i aksioneve

Primi i aksioneve përfaqëson vlerën e kontributeve që arkëtohet mbi vlerën nominale të aksioneve që janë emetuar.

(iii) Dividendët për aksionet e zakonshme

Banka ProCredit sha, Rr. "Dritan Hoxha", Tiranë, Shqipëri.

Dividendët për aksionet e zakonshme njihen në kapital për periudhën gjatë të cilës miratohen nga aksionarët e Bankës. Dividendët për periudhën që deklarohen pas datës së raportimit pasqyrohen si ngjarje pas përfundimit të periudhës së raportimit.